



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 1

16 janar

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.7916 datë 7.1.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3
Dekret nr.7917 datë 8.1.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3
Vendim i KM nr. 1, datë 10.1.2013	Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo sh.a., Albania, në kuadër të kontratës përkatëse, ndërmjet kësaj banke dhe KESH, sha-së..... 4
Vendim i KM nr. 3, datë 4.1.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Lajthi” dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 4
Vendim i KM nr. 5, datë 4.1.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Bulqizë të qarkut të Dibrës ... 5
Vendim i KM nr. 6, datë 4.1.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës..... 6
Vendim i KM nr. 7, datë 4.1.2013	Për një ndryshim në vendimin nr.431, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Gramshit të qarkut të Elbasanit”..... 7

Vendim i KM nr. 9, datë 4.1.2013	Për miratimin e çmimit të teksteve shkollore për nxënësit e shkollave të arsimit profesional, nxënësit e pakicave kombëtare dhe nxënësit shqiptarë që jetojnë e arsimohen në diasporë.....	12
Vendim i KM nr. 19, datë 9.1.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 383, datë 19.5.2010, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, të ndryshuar.....	15
Vendim i ERRU nr. 1, datë 7.1.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Lezhë.....	16
Vendim i ERRU nr. 2, datë 7.1.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Lushnjë qytet.....	17

DEKRET
Nr.7916, datë 7.1.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Fadil Hamza Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr.7917, datë 8.1.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7, të nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Baton Rifat Osmani
2. Luan Rifat Osmani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



VENDIM

Nr. 1, datë 10.1.2013

PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO SHA, ALBANIA, NË KUADËR TË KONTRATËS PËRKATËSE, NDËRMJET KËSAJ BANKE DHE KESH, SHA-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 3 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo, sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huas, ndërmjet kësaj banke dhe KESH, sh.a., për shumën 4 200 000 000 (katër miliardë e dyqind milionë) lekë.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 3, datë 4.1.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “LAJTHI” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3b të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Lajthi” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) % të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Al-Can Hydropower Energy” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Lajthi”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 5, datë 4.1.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BULQIZË TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Bulqizë, të qarkut të Dibrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 377 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Bulqizë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Bulqizë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e arsimit	Në pronësi
18-22	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
48	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
49,50	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
51	Shërbim funeral	Në pronësi
52,61-65	Troje të lira dhe hapësira publike	Në përdorim
53-60	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
322,323	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të	Në përdorim



	ushqimit (toka produktive)	
324,325	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi
66-73	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (truall dhe ndërtesë)	Në përdorim
356	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të bardha e të zeza	Në pronësi
328-354	Infrastrukturë vendore (rrugë vendore, lulishte, trotuar, sheshe)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 6, datë 4.1.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS DISHNICË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 48 (dyzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 316 (treqind e gjashtëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dishnicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dishnicë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
15-18, 311-316	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
19-32	Varrezat publike	Në pronësi

33-43	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe dhe shërbime publike)	Në pronësi
87-89,91-93,95-96,98-100, 102-103,105-106,108-110,112, 114-115,117-119,121-124,126-127, 129, 130, 132-133, 135-137	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
90,94,97,101,104,107,111,113, 116,120,125,128,131,134,138, 141-142,148-149,152,154,159, 160 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta)	Në pronësi
180-183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 7, datë 4.1.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.431, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SË GRAMSHIT TË QARKUT TË ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Gramsh të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.431, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të disa pronave, sipas formularit dhe lidhjes nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, bashkia Gramsh dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Gramsh		Lidhja nr.1
Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Sipërfaqja që i zbritet pronës, m ²	Pronari
137	64.9	Gjergj Xhangolli Zenel Ciroku
150	163.8	Sabri Ibrahimimi
120	125.51	Nexhip Koci



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Nr. Rend.	Zona Kadastre & Pasurise Indeksit Heritas	Lloji i Prones	B			C			Te dhena te tjera (Sherime te vecanta)	
			Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertesë (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Emri me pergjesis administrative	Institucioni / Emri me pergjesis juridike (Statusi Juridik) per dorimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
137	1842 GR-I-3	Trrall	Trrall Lagjia "Sporti" Bashkia Gramsh	955			Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte me pronar Gjergji Xhangol 28.9 m2 pronar Zanal Ciroku 35 m2
150	1842 GR-I-3	Trrall	Trrall Lagjia "Sporti" Bashkia Gramsh	163.8			Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte 163.8 me pronar Sabri Ibrahim
120	1842 GR-I-3	Trrall	Trrall Lagjia "Sporti" Bashkia Gramsh	418			Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte 125.5 m2 me pronar Nexhep Koci
168	1842 GR-I-3	Trrall	Trrall Lagjia "Sporti" Bashkia Gramsh	445			Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte 445 m2 me pronare Sanie Koci
161	1842 GR-I-3	Trrall	Trrall Lagjia "Holla" Bashkia Gramsh	415			Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte 78.76 m2 me pronar Ton Kalla

168	445	Sanie Koci
161	78.76	Ton Kola
44	126	Ardian Feimi
235	826.4	Ferit Mema
206	224	Dylber Mema
148	106	Qani Ismaili
60	32.6	Kujtim Lila
162	37.8	Kadrie Ibra
283	200	Kujtim Hoxha
59	27	Nazmie Driza
186	173	Sulo Lila
134	20	Ardian Dyrmishi
268	79.60	Ramadan Bici

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHITEJEKROKE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)



Dhurata Çimo (Specialiste e Pronave)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Kastriot Zëra (Kryetari i Bashkise)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Identifikoi:
Supervizori:
Aprovoi:

Bashkia Gramsh

Fusha e Perdorimit te Pronave: Infrastruktura dhe sherbime Publike

Nr. Rendi	A				B			C		
	Zona Kadastr. & Indeks i Hartes	Tipi i Prones	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
258	1842 GR-H-3	03	Truall	Truall Lagjia " Holta " Bashkia Gramsh	416		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramdh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 79.60 M2 me pronar Ramadan Bici



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
44	1842 GR-G-3	6/41	Truall	Truall Lagjia " 18 Gushti " Bashkia Gramsh	165.5		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 126 m2 me pronar Ardian Feimi
235	1842 GR-H-3	4/28	Truall	Truall Lagjia " Xhile Lici " Bashkia Gramsh	826.4		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet 826.4 m2 me pronar Ferit Memaj .
206	1842 GR-H-3	4/36	Truall	Truall Lagjia " Xhile Lici " Bashkia Gramsh	224		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet 224 m2 me pronar Dylber Memaj
148	1842 GR-H-3	7/82	Truall	Truall Lagjia "Holla " Bashkia Gramsh	593		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 106 m2 me pronar Qazir Ismaili
60	1842 GR-H-3	7/143	Truall	Truall Lagjia "Holla " Bashkia Gramsh	153.6		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 32.6 m2 me pronar Kujtim Lila
182	1842 GR-G-3	6/8	Truall	Truall Lagjia " 18 Gushti " Bashkia Gramsh	736		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 37.8 m2 me pronar Kadrie Ibra
283	1842 GR-J-3	9/1	Truall	Truall Lagjia " 18 Gushti " Bashkia Gramsh	850		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 200 m2 me pronar Kujtim Hoxha
59	1842 GR-H-3	7/133	Truall	Truall Lagjia "Holla " Bashkia Gramsh	919		Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 27 m2 me pronar Nazmie Driza

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

186	1842	5/53	Truall	Truall Lagjia "18 Gushti" Bashkia Gramsh	595	Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshle S= 173 m2 me pronar Sulo Lila
134	1842	8/89	Truall	Truall Lagjia "Sporti" Bashkia Gramsh	653	Infrastruktur Vendore	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	Siperfaqja qe hiqet eshte S= 20 m2 me pronar Ardian Dëmyshi



VENDIM
Nr. 9, datë 4.1.2013

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË TEKSTEVE SHKOLLORE PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË ARSIMIT PROFESIONAL, NXËNËSIT E PAKICAVE KOMBËTARE DHE NXËNËSIT SHQIPTARË QË JETOJNË E ARSIMOHEN NË DIASPORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të teksteve shkollore për nxënësit që ndjekin arsimin profesional, nxënësit e pakicave kombëtare, si dhe për nxënësit shqiptarë që jetojnë e arsimohen në diasporë, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Çmimet e shitjes së teksteve shkollore të certifikuara, të miratuara sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi, të vendosen në kopertinën e tyre. Për çdo ribotim, çmimet e teksteve shkollore të miratuara indeksohen në përputhje me rritjen vjetore të inflacionit, të publikuar nga INSTAT-i.

3. Tekstet shkollore u shiten ose u jepen falas nxënësve që ndjekin shkollat e arsimit profesional, nxënësve të pakicave kombëtare dhe nxënësve të familjeve shqiptare që jetojnë e arsimohen në diasporë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Të gjitha të ardhurat e realizuara nga shitja e teksteve shkollore arkëtohen në buxhetin e shtetit.

5. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1
LISTA ME ÇMIMET E SHITJES SË TEKSTEVE SHKOLLORE TË NXËNËSVE QË NDJEKIN
SHKOLLAT E ARSIMIT PROFESIONAL, NXËNËSIT E PAKICAVE KOMBËTARE DHE
NXËNËSIT E FAMILJEVE SHQIPTARE QË JETOJNË DHE ARSIMOHEN NË DIASPORË

Grupi	Tirazhi (kopje)	Nr.faqeve tekst	Nr. ngjyrave	Çmimi i shitjes së tekstit (lekë)		
1	deri 100	deri 50	1	190		
			4	400		
		50-100	1	260		
			4	400		
		100-200	1	400		
			4	400		
		200-300	1	400		
			4	400		
		mbi 300	1	400		
			4	400		
		2	100-200	deri 50	1	150
					4	400
50-100	1			217		
	4			400		
100-200	1			400		
	4			400		
200-300	1			400		
	4			400		
mbi 300	1			400		
	4			400		
3	200-300			deri 50	1	400
					4	400
		50-100	1	165		
			4	400		
		100-200	1	315		
			4	400		
		200-300	1	400		
			4	400		
		mbi 300	1	400		
			4	400		
		4	300-400	deri 50	1	90
					4	400
50-100	1			140		
	4			400		
100-200	1			300		
	4			400		
200-300	1			400		
	4			400		
mbi 300	1			400		
	4			400		
5	400-500			deri 50	1	85
					4	400
		50-100	1	135		
			4	400		
		100-200	1	285		
			4	400		
		200-300	1	400		



			4	400
		mbi 300	1	400
			4	400
6	500-600	deri 100	1	220
			4	400
		100-200	1	330
			4	400
		200-300	1	400
			4	400
7	600-1000	deri 100	1	200
			4	340
		100-200	1	270
			4	400
		200-300	1	360
			4	400
8	1000-1500	deri 100	1	180
			4	300
		100-200	1	170
			4	400
		200-300	1	330
			4	400
9	1500-2000	deri 100	1	160
			4	270
		100-200	1	250
			4	400
		200-300	1	320
			4	400
10	2000-2500	deri 100	1	140
			4	250
		100-200	1	230
			4	400
		200-300	1	300
			4	400
11	2500-3000	deri 100	1	120
			4	240
		100-200	1	220
			4	400
		200-300	1	240
			4	400
12	3000-5000	deri 100	1	100
			4	220
		100-200	1	190
			4	370
		200-300	1	210
			4	380
13	5000-10000	deri 100	1	60
			4	150
		100-200	1	170
			4	310
		200-300	1	200
			4	400

VENDIM
Nr. 19, datë 9.1.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 383, DATË 19.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË
FONDIT TË KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 8 të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të nenit 15/1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 383, datë 19.5.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. AKKP-ja, brenda 5 ditëve nga miratimi i kërkesës dhe listës së subjekteve që kompensohen, kryen veprimet me degën e thesarit dhe bankën e nivelit të dytë për derdhjen e shumës në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

Për marrjen e kësteve në vijimësi, subjekti përfitues nuk duhet të paraqesë kërkesë të re për përfitim. AKKP-ja, në varësi të kriterëve të shpërndarjes së fondit të kompensimit dhe gjendjes së tij, bën derdhjen e shumës përkatëse në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, duke e njoftuar atë për veprimin bankar të kryer”.

b) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. AKKP-ja realizon ndarjen e fondit të kompensimit të pronave në vlerë proporcionale me masën përkatëse të parashikuar në listat bashkëlidhur vendimeve të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë shpërblimin e pronarëve për pasuri, të cilat preken nga ndërtimet informale, deri në të njëjtën masë të përfituar në këstin e parë nga subjektet e kompensuara më parë.

Pjesa e fondit, e mbetur pa u shpërndarë, si pasojë e mosaplikimit të subjekteve përkatëse, shpërndahet nga AKKP-ja në vlerë proporcionale, për këstet e mbetura të subjekteve që kanë përfituar të drejtën e shpërblimit më parë në kohë. Fillimisht, nëse pjesa e mbetur e fondit është e mjaftueshme, AKKP-ja procedon me shpërndarjen deri në masën e plotë të shpërblimit për subjektet, të cilëve u ka lindur e drejta e kompensimit njëkohësisht dhe më parë në kohë, krahasuar me subjektet e tjera, referuar datës së vendimit të Këshillit të Ministrave, që përcakton shpërblimin e pronarëve për pasuri të cilat preken nga ndërtimet informale.

Në këtë mënyrë vijohet deri në shpërndarjen e vlerës së plotë të shpërblimit për të gjitha subjektet që e kanë përfituar këtë të drejtë me vendime të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë shpërblimin e pronarëve për pasuri të cilat preken nga ndërtimet informale.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 1, datë 7.1.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK LEZHË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe Metodologjisë mbi Vendosjen e Tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Lezhë tarifat si më poshtë:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë

	Tarifa fikse lekë/muaj/klient	Tarife volumetrike lekë/m ³
Konsumator familjar (me dhe pa matës)	150	55
Institucione buxhetore	200	120
Ente private	200	130

b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura

Konsumator familjar	-	14
Institucione buxhetore	-	18
Ente private	-	22

2. Objektivat e treguesve të performancës të shoqërisë për vitin 2013

- uji pa të ardhura (humbjet)	47%
- niveli i matjes	82%
- kohëzgjatja e furnizimit	20 orë/ditë
- efienca e energjisë	2,5 kwh/ m ³
- efikasiteti i stafit	6,5 staf/000 lidhje
- mbulimi me ujë	90%
- mbulimi me kanalizime	90%
- norma e arkëtimit	80%
- cilësia e ujit (klor+ koliform)	100% norma e sigurisë

3. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Lezhë do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 2, datë 7.1.2013

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK
LUSHNJË QYTET**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe Metodologjisë mbi vendosjen e tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Lushnjë tarifat si më poshtë:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë

	Tarifa fikse lekë/muaj/klient	Tarifë volumetrike lekë/m ³
Konsumator familjar (me dhe pa matës)	100	52
Institucione buxhetore	200	120
Ente private	200	130

b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura

Konsumator familjar	-	14
Institucione buxhetore	-	18
Ente private	-	20

Shitje uji me shumicë 32

2. Objektivat e treguesve të performancës të shoqërisë për vitin 2013

- uji pa të ardhura (humbjet)	60%
- niveli i matjes	90%
- kohëzgjatja e furnizimit	8 orë/ditë
- efienca e energjisë	0.6 kwh/ m ³
- efikasiteti i stafit	5.7 staf/000 lidhje
- mbulimi me ujë	85%
- mbulimi me kanalizime	72%
- norma e arkëtimit	90%
- cilësia e ujit (klor + koliform)	100% norma e sigurisë

3. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Lushnjë do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 16.1.2013
Doli nga shtypi më 16.1.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 22 lekë